



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 korrik 2014
Nr.ref.:RK681/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI90/14

Parashtrues

Rrahim Preteni

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Ac. nr. 1067/13, të 17 janarit 2013

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Rrahim Preteni, me vendbanim në fshatin Melenicë, komuna e Mitrovicës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Ac. nr. 1067/13, të 17 janarit 2013 (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), të cilin e ka pranuar më 3 shkurt 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1067/13, të 17 janarit 2013, me të cilin parashtruesi pretendon se i është shkelur e drejta në punë.

Baza juridike

4. Baza juridike për këtë rast është: neni 113.7 i Kushtetutës, neni 20 dhe 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 5 maj 2014 parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 10 maj 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI90/14, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI90/14, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
7. Më 10 qershor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe po ashtu informoi Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kësaj kërkesë.
8. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën për përjashtimin e tij nga seancat shqyrtuese për periudhën qershor-korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij.
9. Më 26 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI90/14, zëvendësoi gjyqtarin Kadri Kryeziu, si gjyqtar raportues të rastit, dhe në vend të tij caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi.
10. Më 2 korrik 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Faktet në procedurë civile

11. Më 25 qershor 2001 Gjykata Komunale në Mitrovicë (Aktgjykimi, C. nr. 22/2001) aprovoi, si të bazuar, kërkesëpadinë e parashtruesit, të ngritur kundër të paditurit Autoriteti Bankar i Kosovës, dega në Mitrovicë (në tekstin e mëtejme: ABK). Me këtë aktgjykim është detyruar ABK-ja që ta kthejë

parashtruesin në vendin e punës dhe t'ia kompensojë pagat e humbura, prej 31 gushtit 2000 deri në ditën e kthimit të tij në punë.

12. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Mitrovicë, ABK-ja, në afat ligjor, ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.
13. Më 26 prill 2002, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë (Aktgjykimi, AC. nr. 142/2001) e refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtruar nga ABK-ja dhe e vërtetoi në tërësi aktgjykimin e gjykatës së instancës së parë.
14. ABK-ja, kundër aktgjykimeve të gjykatave të instancës më të ulët, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të ligjit material, ka ushtruar revizion në Gjykatën Supreme.
15. Më 26 nëntor 2002, Gjykata Supreme (Aktgjykimi, Rev. nr. 80/2002) e aprovoi revizionin e ushtruar nga ABK-ja dhe i ndryshoi aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, për faktin se të njëjtat në mënyrë të gabuar aplikuan ligjin material.
16. Më 28 janar 2003, parashtruesi, kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme, në të njëjtën gjykatë, ushtroi kërkesë për përsëritjen e procedurës, për shkak të mosmarrjes parasysh të fakteve relevante të kërkesëpadisë së tij dhe për shkak të vendosjes së rastit pa zhvilluar seancë shqyrtuese.
17. Më 22 maj 2007, Gjykata Supreme (Aktvendimi, PPC. nr. 2/2006), refuzoi, si të pabazuar, kërkesën e parashtruesit për përsëritjen e procedurës. Refuzimin e kërkesës për përsëritjen e procedurës, gjykata në fjalë e kishte arsyetuar duke u bazuar në faktin se e njëjta kishte vendosur me revizion në bazë të nenit 391 të LPK-së, sipas të cilit nen, gjykata për revizion vendos pa zhvilluar seancë shqyrtuese.

Faktet në procedurë përmbarimore

18. Më 23 maj 2002, parashtruesi, në cilësinë e kreditorit, në Gjykatën Komunale në Mitrovicë, ushtroi propozim për përmbarimin e Aktgjykimit C. nr. 22/2001, të 25 qershorit 2001.
19. Më 7 qershor 2002, Gjykata Komunale në Mitrovicë (Aktvendimi, E. nr. 273/2002), aprovoi propozimin e parashtruesit për përmbarimin e Aktgjykimit C. nr. 22/2001, të 25 qershorit 2001, me të cilin u detyrua ABK-ja (debitori) që ta kthejë në punë parashtruesin dhe t'ia kompensojë të gjitha pagat e humbura, nga dita e largimit deri në kthimin definitiv të tij në vendin e punës.
20. Më 17 qershor 2002, ABK-ja ushtron kundërshtim kundër Aktvendimit E. nr. 273/2002, me të cilin u lejua përmbarimi i Aktgjykimit C. nr. 22/2001, të 25 qershorit 2001.
21. Më 12 korrik 2002, Gjykata Komunale në Mitrovicë (Aktvendimi, E. nr. 273/2002) refuzoi, si të pabazuar, kundërshtimin e ushtruar nga ABK-ja.

22. Më pas, ABK-ja, kundër Aktvendimit E. nr. 273/2002, të 12 korrikut 2002, në afat ligjor, ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, duke kërkuar pezullimin e Aktgjykimit C. nr. 22/2001, të 25 qershorit 2001, të gjykatës së instancës së parë.
23. Më 17 qershor 2005, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë (Aktgjykimi, Ac. nr. 91/2002), refuzoi ankesën e ABK-së për pezullimin e përmbarimit të Aktgjykimit C. nr. 22/2001, të 25 qershorit 2001 dhe e vërtetoi Aktvendimin E. nr. 273/2001, me të cilin u lejua përmbarimi i Aktgjykimit C. nr. 22/2001, i së njëjtës gjykatë.
24. Më 24 janar 2013, parashtruesi, në cilësinë e kreditorit, ushtroi urgjencë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, duke kërkuar përmbarim të dhunshëm të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Mitrovicë, E. nr. 273/2002, të 7 majit 2002 dhe të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 142/2001, të 26 prillit 2002.
25. Më 19 shkurt 2013, Gjykata Themelore në Mitrovicë (Aktvendimi E. nr. 594/2009), duke u bazuar në Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Mitrovicë, E. nr. 273/2002, të 7 majit 2002, dhe në Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 142/2001, të 26 prillit 2002, lejoi përmbarimin e Aktgjykimit C. nr. 22/2001, të 25 qershorit 2001, me të cilin parashtruesi fitoi të drejtën për kthim në punë dhe për kompensim të pagave të humbura.
26. ABK-ja, kundër Aktvendimit E. nr. 594/2009, të 19 shkurtit 2013, ushtroi kundërshtim në të njëjtën gjykatë, duke u bazuar në faktin se Gjykata Supreme me revizion i kishte ndryshuar aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët.
27. Më 29 mars 2013, Gjykata Themelore në Mitrovicë (Aktvendimi E. nr. 594/2009) aprovoi kundërshtimin e ushtruar nga ABK-ja, duke arsyetuar se akti juridik i cili pretendohet, si titull ekzekutiv për përmbarim, nuk e kishte fituar plotfuqishmërinë e tij në mënyrë përfundimtare, për faktin se Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. nr. 80/2002, të 26 nëntorit 2002, i ndryshoi aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, duke e refuzuar kështu kërkesëpadinë e parashtruesit për kthimin e tij në punë dhe për kompensimin e pagave të humbura.
28. Më 4 prill 2013, parashtruesi, kundër Aktvendimit E. nr. 594/2009, të 29 marsit 2013, të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit.
29. Më 17 janar 2014, Gjykata e Apelit në Prishtinë (Aktvendimi Ac. nr. 1067/2013) e refuzoi si të pabazuar, ankesën e parashtruesit dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, E. nr. 594/2009, të 29 marsit 2013.
30. Për më tepër, Gjykata e Apelit arsyeton vendimin e saj si në vijim:

“Nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore të kreditorit, se ekzistojnë aktgjykimet e plotfuqishme të Gjykatës Komunale dhe asaj të Qarkut me të cilat është lejuar përmbarimi i propozuar, mirëpo nuk sqaron ndonjë fakt tjetër i cili

do të ishte me rendësi që kjo çështje përmbarimore të priset ose të ndryshohet në favor të kreditorit, atëherë të gjitha këto i refuzoi si të pa bazuara. Meqë në rastin konkret ekzistojnë aktgjykimet e instancës me të lartë gjyqësore në vend, pra Gjykatës Supreme të Kosovës, sipas të cilave paditësit në rastin konkret kreditorit, i është ndryshuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, ku ka qenë vendosur në favor të tij dhe është refuzuar edhe propozimi i tij për përsëritje të procedurës, atëherë rezulton se, në situatën konkrete nuk ekziston titull ekzekutiv përmbarimi i të cilit kërkohet, meqë aktgjykimet e instancave më të ulëta janë ndryshuar në dëm të kreditorit dhe se kthimi i tij në vendin e punës në procedurë përmbaruese është i pa mundur.

Megjithatë, gjykata e shkallës së parë në situata të tilla kur e aprovon prapësimin, varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera, kjo decidivisht është përcaktuar me dispozitën e nenit 57 par. 1 lidhur me paragrafin 3 të LPP, mirëpo, në situatën e krijuar edhe sikur aktvendimi i atakuar të priset bazuar në këtë dispozitë, kolegji vlerëson se gjendja faktike nuk mund të ndryshohet dhe kreditori nuk mund të realizojë kërkesën e tij.

Kështu që qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë lidhur me këtë çështje, në tërësi e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, si qëndrim të drejtë dhe të ligjshëm, ndërsa pretendimet e kreditorit i refuzon si të pa bazuara në prova konkrete. Edhe pse kreditori nuk e ka goditur aktvendimin e atakuar për ndonjë shkelje esenciale të procedurës, megjithatë gjykata e shkallës së dytë aktvendimin e atakuar e vlerësoi edhe në këtë aspekt dhe konstatoi se aktvendimi i tillë nuk është përfshirë me ndonjë shkelje esenciale të procedurës nga dispozita e nenit 182 par. 2 lidhur me nenin 194 të LPK të cilat gjykata i vështron sipas detyrës zyrtare, e të cilat shkelje do të ndikojnë në drejtëshmerinë dhe ligjshmërinë e aktvendimit të atakuar”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit, me Aktvendimin e saj, Ac. nr. 1067/2013, të dhënë në procedurë përmbarimore, ka shkelur të drejtën e tij për kthimin në vendin e punës. E gjithë kjo, për faktin se e njëjta refuzoi lejimin e përmbarimit të Aktgjykimit C. nr. 22/2001, të 25 qershorit 2001, që ishte aprovuar me Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Mitrovicë, E. nr. 273/2002, të 7 majit 2002 dhe me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 142/2001, të 26 prillit 2002.
32. Ai pretendon se Gjykata e Apelit, refuzimin e lejimit të propozimit për përmbarim e bazoi në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 80/2002, me të cilin u aprovua revizioni i ABK-së dhe u refuzua kërkesëpadia e parashtruesit. Sipas parashtruesit, Gjykata e Apelit e refuzoi propozimin e parashtruesit për përmbarim edhe përkundër faktit se aktvendimi i gjykatës së instancës së parë ishte bërë i plotfuqishëm dhe përfundimtar.

Pranueshmëria e kërkesës

33. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës së Gjykatës.
34. Përkitazi me këtë kërkesë, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:
- “Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*
35. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) c) i Rregullores së punës, parasheh se:
- (1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
[...]
c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.*
36. Për më tepër, rregulli 36 (2) i Rregullores së punës parasheh që:
- (2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...]
b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;
[...]
d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*
37. Në rastin konkret, Gjykata vëren se, parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata e Apelit shkeli të drejtën e tij për kthimin në punë, për shkak se refuzoi propozimin për përmbarimin e Aktgjykimit C. nr. 22/2001, të 25 qershorit 2001, edhe përkundër faktit që me Aktvendimin E. nr. 273/2002 të Gjykatës Komunale në Mitrovicë i është lejuar përmbarimi dhe i cili ishte bërë i plotfuqishëm dhe përfundimtar, pas refuzimit të ankesës së ABK-së nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë.
38. Sa i përket pretendimit të parashtruesit, se vendimi i gjykatës së instancës së parë ishte bërë i formës së prerë pas vërtetimit të aktvendimit të saj nga gjykata e instancës së dytë, në procedurë përmbarimore, Gjykata konsideron se vendimet e gjykatave të instancës më të ulët, në procedurë përmbarimore, nuk mund të konsiderohen si çështje e gjykuar, përderisa kundër vendimeve të gjykatave të instancës më të ulët, në procedurë të rregullt civile, palët e pakënaqura ushtrojnë ankesë në instancë më të lartë gjyqësore, siç është rasti konkret, me revizionin e ushtruar në Gjykatën Supreme, nga ABK-ja.
39. Megjithatë, aktvendimi i Gjykatës së Apelit është i qartë, i kuptueshëm dhe përmban një arsyetim të gjerësishëm dhe gjithpërfshirës dhe bazohet në një aktgjykim të vendosur nga Gjykata Supreme, e cila ndryshoi vendimet e gjykatave të instancës më të ulët. Natyrisht, është e kuptueshme që Gjykata Supreme, si instancë më e lartë e gjyqësorit të rregullt, ka juridiksion për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimeve të nxjerra nga gjykatat e instancës më të

ulët, nëse vendimet tyre kontestohen nga pala a palët, siç është rasti konkret (shih, arsyetimin e aktvendimit të Gjykatës së Apelit, në paragrafin 29 të këtij dokumenti).

40. Prandaj, Gjykata konsideron se, pretendimet e parashtruesit për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, nuk paraqesin bazë të mjaftueshme kushtetuese për aprovimin e kërkesës së tij, si të pranueshme.
41. Për më tepër, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me aktvendimin e nxjerrë nga Gjykata e Apelit. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, § 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).
42. Gjykata, në rastin konkret, nuk mund të konsiderojë që procedurat e zhvilluara në Gjykatën e Apelit kanë qenë të njëanshme ose në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, *Shub vs. Lithuania*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
43. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se, kërkesa e parashtruesit, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe të rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me rregullin 36 (1) c), rregullin 36 (2) b) dhe d), si dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores, më 2 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Arta Rama-Hajrizi



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani